



## UDHËZIMET RRETH PROGRAMIT TË VIZAVE EMIGRUESE TË SHUMËLLOJSHMËRISË (LOTARISË AMERIKANE) (DV-2015)

### Një vështrim i përgjithshëm i programit

Programi i Vizave Emigruese të Shumëllojshmërisë, i autorizuar nga Kongresi, administrohet nga Departamenti i Shtetit në bazë vjetore. Seksioni 203(c) i Aktit të Emigracionit dhe Kombësisë (INA) mundëson viza për një grup emigrantësh të njohur si “emigrantë të shumëllojshmërisë” prej vendeve me shkallë historikish të ulët emigrimi në Shteteve të Bashkuara. Për vitin fiskal 2015, do të jenë në dispozicion 50,000 viza emigrantësh të shumëllojshmërisë (DV). Regjistrimi për Programin e Lotarisë është falas.

Aplikantët që janë përzgjedhur nga programi i lotarisë (“të përzgjedhurit”) duhet të plotësojnë kërkesa të thjeshta, por të rrepta, të pranueshmërisë në mënyrë që të kualifikohen për një vizë shumëllojshmërie. Një kompjuter përzgjedh rastësisht aplikantët për vizën e lotarisë. Vizat e lotarisë shpërndahen ndërmjet gjashtë rajoneve gjeografike dhe asnjë vend i veçantë nuk mund të përfitojë më shumë se 7% të Lotarive (DV-ve) të disponueshme për çdo vit.

Për Lotarinë DV-2015, vendasit e shteteve të mëposhtme nuk janë të ligjshëm për të aplikuar, pasi këto shtete kanë dërguar në total më shumë se 50,000 emigrantë në SHBA në pesë vitet e shkuara:

Bangladesh, Brazil, Kanada, Kinë (të lindurit në kontinent), Kolumbi, Republika Domenikane, Ekuador, San Salvador, Haiti, India, Xhamaika, Meksikë, Nigeri, Pakistan, Peru, Filipine, Koreja e Jugut, Mbretëria e Bashkuar (me përjashtim të Irlandës së Veriut) territoret e varura prej saj dhe Vietnam.

Personat e lindur në Hong Kong SAR, Makau SAR dhe Taivan janë të ligjshëm.

Ndryshimet e këtij viti për pranueshmërinë: Për DV-2015, të lindurit në Nigeri nuk janë më të ligjshëm.

### Ligjshmëria:

**Kërkesa #1:** Individët të lindur në një vend, vendasit e të cilit kualifikohen për të aplikuar për programin e lotarisë, mund të jenë të ligjshëm për të hyrë në Shtetet e Bashkuara.

Nëse nuk keni lindur në një vend të pranueshëm për të aplikuar për lotarinë, ka dy mënyra me anë të të cilave ju mund të kualifikoheni.

- A ka lindur bashkëshort-i/ja juaj ka në një vend të pranueshëm për të aplikuar për lotarinë? Nëse po, ju mund të deklaroni vendin e lindjes së bashkëshort-it/es në regjistrimin për lotarinë— me kushtin që ju dhe bashkëshort-i/ja jeni listuar në aplikimin e përzgjedhur, do t'ju lëshohet viza dhe do të hyni në SHBA në të njëjtën kohë.

- A keni lindur në një shtet jo të pranueshëm për të aplikuar për lotarinë, por asnjëri nga prindërit tuaj s'ka lindur, apo s'ka banuar atje në kohën kur ju keni lindur? Nëse po, ju mund të deklaroni si vendlindje një nga vendlindjet e prindërve tuaj, nëse ky vend është vend i kualifikueshëm për programin e DV-2015. Për më shumë detaje mbi kuptimin e paragrafit të mësipërm, lexoni Pyetje të Shtruara Shpesh.

**Kërkesa #2:** Për më tepër, për të plotësuar ose kërkesat e arsimit ose kërkesat e eksperiencës së punës të kualifikueshme të programit të lotarisë, ju duhet të keni:

- Një arsim të shkollës së mesme apo ekuivalentin e tij, përkufizuar si përfundim me sukses i 12 viteve edukim të plotë 9-vjeçar dhe i mesëm;

OSE

- 2 vjet eksperiencë pune brenda 5 viteve të kaluara në një punësim që kërkon të paktën 2 vjet trajnim ose eksperiencë për ta ushtruar. Për të përcaktuar nëse eksperiencia e punës kualifikohet për lotarinë, do të përdoret Baza e të Dhënave të Departamentit Amerikan të Punës [O\\*Net OnLine](#).

Për më shumë informacion rreth eksperiencës së punës së kualifikueshme, shikoni lexoni Pyetje të Shtruara Shpesh.

Në qoftë se ju nuk mund të plotësoni asnjërën prej këtyre kërkesave, ju NUK duhet të aplikoni në Programin e Lotarisë.

### **Periudha e regjistrimit**

Regjistrimi për Programin e Lotarisë DV-2015 duhet të kryhet në mënyrë elektronike në: [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov), midis mesditës, Orës Ditore Lindore (EDT) (GMT-4), e Martë, 1 Tetor 2013, dhe mesditës, Orës Ditore Lindore (EDT) (GMT-4), e Shtunë, 2 Nëntor 2013.

Mos prisni deri në javën e fundit të periudhës së regjistrimit, pasi kërkesat e shumta mund të shkaktojnë mbingarkesë të faqes së internetit. Aplikimet me letër ose aplikimet e vonuara nuk do të pranohen. Ligji lejon vetëm një regjistrim për cdo person gjatë periudhës së regjistrimit. Departamenti i Shtetit përdor teknologji të sofistikuar për t'u vënë në dijeni të regjistrimeve të shumëfishta. **Në rast se është marrë më shumë se NJË regjistrim (aplikim) për lotari nga një individ, atëherë ju do të skualifikoheni.**

### **Plotësimi i regjistrimit elektronik për Programin e Lotarisë DV-2015.**

Dërgoni online në faqen zyrtare [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov), Formën Elektronike të Regjistrimit për Vizën e Shumëllojshmërisë (E-DV Entry Form ose DS-5501). Regjistrimet e papërfunduara do të skualifikohen. Regjistrimi për Programin e Lotarisë është falas.

Jeni të inkurajuar të plotësoni vetë formën e regjistrimit, pa ndihmën e një "Këshilltari për Vizat", "Agjenti të Vizave" ose personave të tjerë që ju ofrojnë ndihmë. Nëse është dikush tjetër që ju ndihmon, duhet të jeni të pranishëm në momentin e përgatitjes së regjistrimit, në mënyrë që t'u

përgjigjeni të gjitha pyetjeve në mënyrë sa më korrekte, të merrni faqen e konfirmimit dhe numrin unik të konfirmimit. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të pajiseni me faqen e konfirmimit dhe numrin unik të konfirmimit. Pa këtë informacion, nuk do të jeni në gjendje të hyni në sistemin online që do t'ju informojë mbi statusin e regjistrimit tuaj. Duhet të jeni të kujdesshëm në rastin kur dikush ofrohet të ruajë faqen e konfirmimit dhe numrin tuaj të konfirmimit. Lexoni Pyetje të Shtruara Shpesh për më shumë informacion rreth Mashtrimeve të Vizave të Shumëllojshmërisë.

Pasi të keni dorëzuar elektronikisht regjistrimin e plotë, do t'ju shfaqet një faqe konfirmimi, e cila përmban emrin tuaj dhe numrin unik të konfirmimit. Printojeni këtë faqe dhe ruajeni. Duke filluar nga 1 Maji 2014, ju do të mund të kontrolloni statusin e regjistrimit tuaj në faqen zyrtare [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov), duke klikuar mbi *Kontrollin e Statusit të të Regjistuarit* dhe duke futur numrin unik të konfirmimit dhe informacionin personal. Kontrolli i Statusit të të Regjistuarit do të jetë e vetmja mënyrë informimi mbi përzgjedhjen tuaj për Lotarinë DV-2015, duke ju dhënë udhëzime se si të vazhdoni më tej me aplikimin tuaj dhe duke ju njoftuar mbi takimin për vizë emigrimi. Lexoni Pyetje të Shtruara Shpesh për më tepër informacion mbi procesin e përzgjedhjes.

Në mënyrë që të plotësoni regjistrimin tuaj E-DV, ju duhet të paraqisni informacionin e mëposhtëm:

1. Emrin – mbiemrin, emrin, emrin e mesit – ekzaktësisht siç shkruhet në pasaportë. Mos vendosni emrin e babait si emër mesit. Vendosni N/A.
  2. Datën e lindjes – ditë, muaj, vit.
  3. Gjininë – mashkull ose femër.
  4. Qytetin e lindjes.
  5. Shtetin e lindjes – Përdorni emrin me të cilin njihet aktualisht shteti ku keni lindur.
  6. Vendi i kualifikueshëm për Programin e Lotarisë – Vendi i kualifikueshëm për Programin e Lotarisë normalisht do të jetë i njëjtë me atë të lindjes. Vendi i kualifikueshëm për Programin e Lotarisë nuk lidhet me vendin ku jetoni. Nëse keni lindur në një vend jo të kualifikueshëm për Programin e Lotarisë, lutemi rishikoni Pyetje të Shtruara Shpesh për të parë nëse ka mënyrë tjetër që mund t'ju bëjë të kualifikueshëm.
  7. Fotografitë e të regjistruarve – Fotografi personale tuajën të kohëve të fundit, të bashkëshortit/es dhe të të gjithë fëmijëve të përfshirë në regjistrim. Shikoni Dorëzimi i Fotografisë Dixhitale për specifikime teknike dhe të kompozimit. Nuk është e nevojshme të përfshini një foto të bashkëshortes/it dhe fëmijëve tashmë qytetarë amerikanë ose Residentë të përhershëm ligjorë, por në rast se i përfshini nuk do të ketë pasojë në aplikimin tuaj për vizë shumëllojshmërie.
- Fotografitë në grup nuk do të pranohen; duhet të paraqisni nga një fotografi për çdo individ. Regjistrimi juaj mund të skualifikohet ose viza juaj të refuzohet nëse fotografitë tuaja nuk janë të kohëve të fundit, janë të manipuluar në një formë apo në tjetrën, ose nuk respektojnë specifikimet e mëposhtme. Shikoni Dorëzimi i Fotografisë Dixhitale për më shumë informacion.
8. Adresa postare – Në emër të

Adresa Rreshti1  
Adresa Rreshti 2  
Qyteti  
Rrethi  
Kodi Postar  
Shteti

**9.** Shteti ku jetoni aktualisht.

**10.** Numri i telefonit (jo i detyruar).

**11.** Adresë E-maili - Një adresë e-maili në të cilën ju keni akses të drejtpërdrejtë. Nëse aplikimi juaj përzgjidhet dhe ju i përgjigjeni njoftimit të përzgjedhjes tuaj nëpërmjet Kontrollit të Statusit të të Regjistruarit, ju do të merrni e-maile të tjera komunikuese nga Departamenti i Shtetit duke ju njoftuar që informacion me detaje i intervistës për vizën emigruese është vendosur në Kontrollin e Statusit të Regjistrimit. Departamenti i Shtetit kurrë nuk do t'ju dërgojë një e-mail duke ju thënë se ju jeni përzgjedhur për programin e DV-së. Shikoni Pyetjet të Shtruara Shpesh për më shumë informacion në lidhje me procesin e përzgjedhjes.

**12.** Niveli më i lartë i arsimimit që ju keni arritur, deri më sot: (1) vetëm Shkollë fillore, (2) disa

vite shkollë të mesme, pa diplomë (3) Diploma e shkollës së mesme, (4) Shkollë profesionale, (5) Disa Kurse universiteti, (6) Diplomë universitare, (7) Disa nivele të kurseve pasuniversitare, (8) Master, (9) Disa Kurse të doktoraturës, dhe (10) doktoraturë. Shih Pyetje të Bëra Shpesh për më shumë Informacion në lidhje me kërkesat arsimore.

**13.** Statusi aktual martesor – I Pamartuar, i martuar, i divorcuar, i ve, ose i ndarë ligjërisht. Vendosni emrin, datën e lindjes, gjininë, qytetin e lindjes, shtetin e lindjes së bashkëshortit/es tuaj, dhe një fotografi të bashkëshortit tuaj që plotëson specifikimet teknike të njëjta si fotoja juaj.

Mosvendosja e bashkëshortit/es tuaj në regjistrimin për lotarinë do të rezultojë në skualifikimin e aplikantit kryesor dhe të refuzimit të të gjitha vizave të rastit në kohën e intervistës për vizë. Ju duhet të listoni bashkëshortin tuaj edhe në qoftë se keni ndërmend të divorcoheni përpara se të aplikoni për një vizë. Një bashkëshort i cili tashmë është një qytetar amerikan apo një banor i ligjshëm i përhershëm nuk do të kërkojë dhe as nuk do t'i lëshohet një vizë DV, edhe pse ju nuk do të penalizoheni në qoftë se ju i listoni në formën tuaj të aplikimit. Shih Pyetje të Bëra Shpesh për më shumë informacion në lidhje me anëtarët e familjes.

**14.** Numri i fëmijëve - Renditni Emrin, datën e lindjes, gjininë, qytetin e lindjes, dhe shtetin e lindjes për të gjithë fëmijët e pamartuar nën moshën 21 vjeç, pavarësisht nëse jetojnë apo jo me ju, apo s'kanë ndërmend t'ju shoqërojnë ose ndjekin për t'u bashkuar me ju të emigroni në Shtetet e Bashkuara. Dërgoni fotografi individuale të secilit prej fëmijëve tuaj duke përdorur specifikimet teknike të njëjta si fotografia juaj.

Sigurohuni që të përfshini:

- të gjithë fëmijët natyralë ;
- të gjithë fëmijët ligjërisht të birësuar nga ju; dhe,

- të gjithë fëmijët nga martesat e mëparshme që janë të pamartuar dhe nën moshën 21 vjeç në datën e aplikimit tuaj elektronik, madje edhe në qoftë se ju nuk jeni më të martuar ligjërisht me prindin e fëmijës, dhe madje edhe në qoftë se fëmija aktualisht nuk banon me ju dhe/ose nuk do të emigrojë me ju.

Fëmijët e martuar dhe fëmijët mbi moshën 21 vjeç nuk janë të pranueshëm për DV. Megjithatë, në rrethana të caktuara Akti i Mbrojtjes të Stausit të Fëmijëve i mbron fëmijët nga "përrjashtimi për shkak të moshës". Nëse aplikimi juaj i DV është bërë para se fëmija juaj i pamartuar të kishte mbushur 21 vjeç, dhe fëmija mbush 21 para lëshimit të vizës, ai / ajo mund të trajtohet sikur ai / ajo të ishte nën 21 për qëllimin e procedimit të vizës.

Një fëmijë i cili tashmë është një qytetar amerikan apo një banor i ligjshëm i përhershëm nuk ka nevojë për një vizë Diversiteti, dhe ju nuk do të ndëshkoheni për mospërfshirjen e anëtarëve të tillë të familjes në aplikimin tuaj.

Mospërfshirja në regjistrimin për lotarinë i të gjithë fëmijëve të cilët kanë të drejtë do të rezultojë në skualifikimin e aplikantit kryesor dhe të refuzimit të të gjitha vizave të rastit në kohën e intervistës për vizë. Shih Pyetje të Bëra Shpesh për më shumë informacion në lidhje me anëtarët e familjes.

Shih Pyetje të Bëra Shpesh për më shumë informacion në lidhje me Përfundimin e Aplikimit tuaj Elektronik për Programin DV-2015.

### **Përzgjedhja e Aplikantëve**

Bazuar në shpërndarjen e vizave të disponueshme për çdo rajon dhe shtet, individët do të përzgjidhen rastësisht nga kompjuteri ndërmjet aplikimeve të kualifikuara. Për të gjithë aplikantët e DV-2015 do të kërkohet të shkojnë tek Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve duke përdorur numrin unik të konfirmimit të ruajtur nga regjistrimi DV-2015 i aplikimit të tyre në internet për të gjetur nëse aplikimi i tyre është përzgjedhur në programin e DV. Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve do të jetë në dispozicion në faqen e internetit të E-DV [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov) duke filluar nga 1 Maji 2014 deri të paktën më 30 Qershor 2015.

Nëse aplikimi juaj përzgjidhet, ju do të drejtoheni tek një faqe konfirmimi që do të japë udhëzime të mëtejshme, përfshirë informacione për pagesat lidhur me emigracionin në Shtetet e Bashkuara. Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve do të jetë mjeti i VETËM me të cilin të përzgjedhurit do të njoftohen për përzgjedhjen e tyre për DV-2015. Departamenti i Shtetit nuk do të dërgojë letra njoftimi ose të njoftojë të përzgjedhurit me email. Ambasadat e Shteteve të Bashkuara dhe konsullatat nuk do të sigurojnë lista për të përzgjedhurit. Individët të cilët nuk janë të përzgjedhur gjithashtu do të njoftohen VETËM përmes Kontrollit të Statusit të Regjistrimit. Ju jeni të inkurajuar fuqimisht të hyni vetë tek Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve dhe të mos mbështeteni tek dikush tjetër për të kontrolluar dhe për t'ju informuar.

Nëse jeni përzgjedhur, në mënyrë që të merrni një vizë DV për të emigruar në Shtetet e Bashkuara, ju prapëseprapë duhet të përmbushni të gjitha kërkesat e pranueshmërisë sipas ligjit të SHBA-së. Këto kërkesa mund të rrisin nivelin e kërkuar të shqyrtimit dhe kohën e nevojshme për shqyrtim për vendastit e disa vendeve të renditara në këtë njoftim, duke përfshirë, por jo kufizuar në, vendet e përcaktuara si shtete sponsorizuese të terrorizmit.

Të gjitha shqyrtimet e aplikimeve dhe lëshimi i vizave DV të aplikantëve të përzgjedhur që kanë plotësuar kërkesat e duhura edhe për anëtarët e familjes së tyre duhet të përfundojnë deri në mesnatë më 30 shtator 2015. Në asnjë rrethanë DV-të nuk mund të lëshohen apo të autorizohen pas kësaj date, dhe as anëtarët e familjes së DV-së të cilët nuk e morën vizën në të njëjtën kohë me aplikantin kryesor nuk mund t'i bashkohen aplikantit kryesor në Shtetet e Bashkuara pas kësaj date. Shih [Pyetje të Bëra Shpesh](#) për më shumë informacion në lidhje me procesin e përzgjedhjes.


### Dërgimi i një fotografie dixhitale (Foto)

Ju mund të merrni një fotografi të re dixhitale apo të skanoni një fotografi me një skaner dixhital, për aq kohë sa ajo i plotëson specifikimet kompozicionale dhe teknike të renditura më poshtë. Testoni fotot tuaja nëpërmjet linkut të vlerësimit të fotos në faqen e internetit të E-DV, e cila ofron këshilla teknike shtesë rreth përbërjes së fotos dhe shembuj të fotografive të pranueshme dhe të papranueshme.

Fotografitë duhet të jetë në 24-bit thellësi ngjyre. Nëse jeni duke përdorur një skaner, përbërësit e fotografisë duhet të jenë "True Color" ose 24-bit me ngjyra. Shikoni kërkesat shtesë të skanimit më poshtë.

### Specifikimet e Përbërjes së Fotografisë:

- **Pozicioni i Kokës**
  - Personi që fotografohet duhet të jetë me fytyrë drejt aparatit.
  - Koka e personit nuk duhet të jetë pozicionuar lart, poshtë ose anash.
  - Lartësia e kokës ose përmasa e fytyrës (matur nga maja e kokës duke përfshirë edhe flokët deri tek pjesa e poshtme e mjekrrës) duhet të jetë nga 50% deri 69% të lartësisë totale të fotografisë. Lartësia e syve (matur nga pjesa e poshtme e fotografisë deri tek niveli i syve) duhet të jetë nga 56% deri 69% të lartësisë së fotografisë.
- **Shembull i Përmasave të Kokës të një Fotoje Dixhitale**



Shikoni shembuj të fotografive në faqen e internetit të [Kërkesave të Fotografisë](#).

- **Sfondi i bardhë**
  - Personi që do të fotografohet duhet të jetë përpara një sfondi të bardhë e të ndriçuar.
- **Epiqendra (fokusi)**
  - Fotografia duhet të jetë në fokus.

- **Jo Sende Dekorative:**
  - Personi që fotografohet nuk duhet të mbajë syze dielli apo sende që zvogëlojnë sipërfaqen e fytyrës.
- **Jo Mbulim të Kokës, as Kapele**
  - Pranohen vetëm fotografitë ku aplikanti ka vendosur shami apo kapele për shkak të besimit fetar; por edhe në këtë rast fytyra nuk duhet mbuluar. Fotografitë, ku aplikanti ka mbuluar fytyrën jo për shkak të besimit fetar, nuk do të pranohen; fotografi të personelit ushtarak, të flotës ajrore ose të çdo personeli tjetër që mban kapele, nuk do të pranohen.

### Specifikimet Teknike të Fotografisë

- **Nxjerrja e fotografisë së re me aparat dixhital.** Në qoftë se është nxjerrë një fotografi e re, ajo duhet të ketë këto specifikime:

Lloji i Formatit të Fotografisë:	Fotografia duhet të jetë e formatit JPEG
Madhësia e Fotografisë:	Maksimumi i madhësisë së fotografisë duhet të jetë 240 KB
Rezolucioni dhe përmasat e Fotografisë:	Dimensionet minimale të pranueshme janë 600 pika (pixels) e lartë me 600 pika (pixels) e gjerë. Dimensi pixel i fotos duhet të jetë në një përpjestim të drejtë (që do të thotë se lartësia duhet të jetë e barabartë me gjatësinë)
Thellësia e Ngjyrave të Fotografisë:	Fotografia duhet të jetë me ngjyra (24-bit per pixel). Fotografitë 24 bit në bardhezi ose 8 bit nuk do të jenë të pranueshme.

- **Skanimi i Fotografisë që do të Dërgohet.** Përpara se fotografia të skanohet, ajo duhet të ketë këto specifikime. Nëse fotografia është me ngjyra dhe me specifikimet e stampimit, skanojeni duke përdorur si më poshtë specifikimet e skanerit:

Rezolucioni i Skanimit:	Të skanohet me rezolucion të paktën 300 dots për inch (dpi)
Lloji i Formatit të Fotografisë:	Fotografia duhet të jetë e formatit JPEG
Madhësia e Fotografisë:	Maksimumi i madhësisë së fotografisë duhet të jetë 240 KB
Rezolucioni i Fotografisë:	600 me 600 pika (pixels)
Thellësia e Ngjyrave të Fotografisë:	Ngjyra 24-bit (Shënim: Fotografi bardh e zi, monokrome, ose stil gri nuk do të pranohen)

## P Y E T J E T Ë B È R A S H P E S H

### 1. Çfarë do të thonë fjalët “vendas” dhe “ngarkimi”?

Vendas në përgjithësi do të thotë dikush që ka lindur në një shtet të caktuar, pavarësisht shtetit aktual të rezidencës së individit apo shtetësisë. Vendas gjithashtu do të thotë që, bazuar në

Seksionin 202(B) të Aktit të Emigracionit dhe Kombësisë, dikush që ka të drejtë t'i ngarkohet një shteti tjetër të ndryshëm nga ai në të cilin ai ose ajo ka lindur.

Për shkak se vendosen kufizime numerike ndaj emigrantëve që vijnë nga një shtet apo në zone gjeografike, secili individ i ngarkohet një shteti. Ngarkimi juaj ka të bëjë me shtetin ndaj të cilit ju llogariteni.

## **2. A mund të aplikoj edhe nëse nuk kam lindur në një nga shtetet kualifikuese?**

Ka dy rrethana në të cilat prapëseprapë ju mund të keni të drejtë për të aplikuar. E para, nëse bashkëshortja derivative ka lindur në një shtet të kualifikueshëm për lotarinë, ju mund të deklaroni ngarkimin ndaj atij shteti. Duke qenë se pranueshmëria juaj për aplikim bazohet tek bashkëshortja juaj, juve do ju lëshohet viza emigruese DV-1 vetëm nëse bashkëshortja juaj do të jetë gjithashtu e pranueshme për dhe t'i lëshohet viza DV-2. Të dy ju duhet të hyni në SHBA së bashku duke përdorur vizën tuaj të DV-së. Në mënyrë të ngjashme, fëmija juaj i mitur mund t'i ngarkohet shtetit të lindjes së prindit.

Së dyti, juve mund t'ju "ngarkohet" vendi i lindjes të njërit prej prindërve tuaj për sa kohë që asnjëri prej prindërve nuk ka lindur në vendin që nuk kualifikohet, ose nuk ka qenë banor i vendit që nuk kualifikohet në kohën e lindjes tuaj. Në përgjithësi, njerëzit nuk konsiderohen banorë të një vendi në të cilin ata nuk kanë lindur ose janë natyralizuar ligjërisht, nëse ata janë vetëm duke vizituar vendin, duke studiuar në vend përkohësisht, ose të vendosur përkohësisht në atë vend për biznes apo arsye profesionale në emër të një kompanie ose qeveri nga një vend tjetër dhe jo nga vendi ku aplikuesi ka lindur.

Nëse ju kërkon ngarkim alternativ, ju duhet ta shënoni një informacion të tillë në Formularin elektronik të DV-së në internet, në pyetjen # 6.

Shënimi i një vendi që nuk kualifikohet ose ngarkohet (p.sh, një vend për të cilin nuk mund të vërtetoni një kërkesë të vlefshme) mund të përjashtojë aplikimin tuaj.

## **3. Përse vendasit e disa shteteve nuk kualifikohen për Programin e DV-së?**

Programi i Lotarisë së Diversitetit (DV) ka për qëllim t'u ofrojë një mundësi emigrimi personave që nuk janë nga vende me "pranim të lartë emigrantësh". Ligji përcakton "shtetet pranim të lartë emigrantësh" ato shtete nga të cilat një total prej 50.000 personash në kategoritë e vizave me Bazë Të Sponsorizuar nga Familjarë dhe me Bazë Punësimi kanë emigruar në Shtetet e Bashkuara gjatë pesë viteve të kaluara. Çdo vit, Shërbimi i Emigracionit dhe Shtetësisë Amerikane (USCIS) bën përllogaritjen e shifrave të emigrantëve që janë pranuar në Amerikë me statusin e familjarit dhe të punësimit në pesë vitet e mëparshme për të identifikuar shtetet ku vendasit e tyre nuk do të jenë të kualifikueshëm (nuk do të kenë të drejtë të aplikojnë) për lotarinë e atij viti. Meqenëse bëhet një përcaktim i veçantë para çdo periudhe vjetore të kohës kur aplikohet për E-DV-në (lotarinë elektronike), lista e vendeve ku vendasit e tyre nuk janë të ligjshëm mund të ndryshojë nga viti në vit.

## **4. Sa viza të DV-2015 do u kalojnë vendasve të secilit rajon dhe shteteve të kualifikueshme?**

Shërbimi i Shteteve të Bashkuara për Shtetësinë dhe Imigracionin (USCIS) përcaktojnë limitet rajonale për DV-në për çdo vit sipas një formule të përcaktuar në Seksionin 203(c) të INA-s. USCIS do të bëjë publike këto shifra pasi të jenë kryer llogaritjet. Numri i vizave që do t'u lëshohen vendasve të secilit shtet do të varen nga caqet rajonale të përcaktuara, nga sa të regjistruar vijnë nga secili shtet, dhe se sa të regjistruar kanë patur të drejtën për vizë. Jo më



shumë se shtatë përqind e totalit të vizave në dispozicion mund t'i kalojnë vendasve të një shteti.

**5. Cilat janë kerkesat për arsim ose eksperiencë pune?**

Ligji dhe rregullat e Emigracionit të Shteteve të Bashkuara kërkojnë që çdo aplikant duhet të ketë të paktën një arsim të shkollës së mesme ose ekuivalentin e saj, ose brenda pesë viteve të fundit të ketë dy vjet përvojë pune në një profesion që kërkon përvojë ose trajnim të paktën dy vjet. Një "arsimim i shkollës së mesme ose ekuivalente" përkufizohet si përfundimi me sukses i një kursi dymbëdhjetëvjeçar fillor dhe të mesëm në Shtetet e Bashkuara ose përfundimin e suksesshëm në një vend tjetër të një kursi edukimi zyrtar të krahasueshëm me filloren dhe të mesmen të një shkolle në arsimin e mesëm në Shtetet e Bashkuara. Vetëm kurset zyrtare të studimit e përmbushin këtë kërkesë, kurset e korrespondencës ose çertifikata të ngjashme (të tilla si me kohë të pjesëshme G.E.D.) nuk janë të pranueshme. Prova të dokumentuara të edukimit ose përvojës së punës duhet t'i prezantohen zyrtarit konsullor në kohën e intervistës për vizë.

**6. Cilat profesione kualifikohen për programin e DV-së**

Për të përcaktuar të drejtën ligjore bazuar në përvojën e punës, do të përdoren përkufizimet e publikuara në bazën e të dhënave të Departamentit të Punës (DOL) [O\\*Net OnLine Database](#). [O\\*Net OnLine Database](#) grupon përvojën e punës në pesë "zona të punës." Edhe pse shumë profesione janë të shënuara në faqen e internetit të Departamentit të Punës (DOL), vetëm disa profesione specifike të caktuara kualifikohen për programin e DV-së. Për t'u kualifikuar për një DV në bazë të përvojës suaj në punë, ju duhet të keni brenda pesë viteve të fundit dy vjet përvojë në një profesion që është përcaktuar si Zonë Pune 4 ose 5, e klasifikuar në një shkallë të Përgatitjes së Vecantë Profesionale (SVP) të vlerës 7.0 ose më lart.

**7. Si mund të gjej punët që të kualifikojnë për DV tek bazën e të dhënave të Departamentit të Punës (DOL) O\*Net OnLine Database?**

Pasi të keni hyrë në [O\\*Net OnLine](#), ndiqni këto hapa për të gjetur se cilat profesione kualifikohen:

1. Nën "Gjej Profesione", zgjidh "Familja e Profesioneve" nga lista poshtë;
2. Kërko sipas "Famijes së Profesioneve", kryeni zgjedhjen tuaj, dhe shtypni "Vazhdo";
3. Zgjidhni lidhjen për profesionin tuaj specifik.
4. Zgjidhni butonin "Zona e Profesionit" për të gjetur numrin e përcaktuar të Zonës së Profesionit dhe gamën e vlerësimit të Përgatitjes Specifike Profesionale (SVP).

Për shembull, zgjidhni Inxhinierët e Hapësirës. Në fund të Raportit Përmbledhës për Inxhinierët e Hapësirës, nën seksionin e Zonës së Profesionit, ju do të gjeni Zonën e përcaktuar të Profesionit 4, gama e SVP, 7.0 deri < 8.0. duke përdorur këtë shembull, Inxhinierët e Hapësirës është një profesion i kualifikueshëm.

Për më tepër informacion, shikoni faqen e internetit të [Vizave të Shumëllojshmërisë – Lista e Profesioneve](#).

**8. A ka një moshë minimale për të aplikuar për programin e E-DV-së?**

Nuk ka moshë minimale për të aplikuar për programin, por kërkesa për shkollim nga një shkollë e mesme ose përvojë pune për secilin aplikant primar në kohën e aplikimit do të ndikojë në skualifikimin e shumë personave që janë nën 18 vjeç.

## **PLOTËSIMI I FORMULARIT TUAJ ELEKTRONIK PËR PROGRAMIN E DV-së**

### **9. Kur mund ta dorëzosh aplikimin tim?**

Periudha e regjistrimit për aplikimin elektronik për DV-2015 do të fillojë në mesditë, Ora Ditore Lindore (GMT-4), E martë, 1 Tetor 2013, dhe do përfundojë në mesditë, Ora Ditore Lindore (GMT-4) E Shtunë, 2 Nëntor 2013. Çdo vit, miliona njerëz aplikojnë për programin e lotarisë gjatë periudhës së regjistrimit. Mbajtja e periudhës së regjistrimit në këto data siguron që të përzgjedhurit të njoftohen brenda afatit dhe u jep kohë për t'u përgatitur si aplikantëve të vizave ashtu dhe ambasadave e konsullatave tona që të plotësojnë rastet për lëshimin e vizave.

Ju inkurajojmë që të aplikoni në fillim të periudhës së regjistrimit. Kërkesat e tepërta nga fundi i periudhës së regjistrimit mund të ngadalësojnë sistemin. Asnjë aplikim nuk do të pranohet pas mesditës (EDT), e Shtunë 2 Nëntor 2013.

### **10. Unë jam në SHBA. A mundem unë të aplikoj për programin e DV-së?**

Po, një aplikant mund të jetë në Shtetet e Bashkuara ose në një shtet tjetër dhe aplikimi mund të kryhet nga kudo ndodheni.

### **11. Më duhet të aplikoj vetëm njëherë gjatë periudhës së regjistrimit?**

Po, ligji lejon vetëm një aplikim nga/ose për secilin person gjatë çdo periudhe të regjistrimit. Departamenti i Shtetit përdor teknologji të sofistikuar për të identifikuar aplikime të shumëfishta. Nëse dorëzoni më shumë se një aplikim do të skualifikoheni.

### **12. A mundet secili nga bashkëshortët të dorëzojë aplikim veçmas?**

Po, secili nga bashkëshortët mund të dorëzojë një aplikim veçmas, nëse secili përmbush kërkesat ligjore. Në qoftë se njëri prej tyre përzgjidhet, tjetri ka të drejtë të aplikojë për statusin e personit ndjekës.

### **13. Cilët anëtarë të familjes duhet të përfshij unë në aplikimin tim elektronik për lotarinë?**

**Bashkëshortët:** Ju duhet të përfshini bashkëshortin apo bashkëshorten pavarësisht faktit se ai/ajo jeton apo ka ndërmend ose jo të emigrojë në Shtetet e Bashkuara. Ju duhet të përfshini bashkëshort-in/en tuaj edhe nëse ju jeni tashmë të ndarë prej tij/saj, përveç rasteve kur jeni ligjërisht të ndarë (p.sh. ka një marrëveshje të shkruar që njihet nga një gjykatë apo një vendim gjykate). Nëse jeni ligjërisht të ndarë, ju nuk keni nevojë për të përfshirë ish-bashkëshort-in/en tuaj në aplikim, sidoqoftë ju nuk do të cënoheni nëse e përfshini atë. Nëse jeni divorcuar apo bashkëshort-i/ja juaj nuk jeton më, mos e përfshini ish-bashkëshort-in/en tuaj në aplikim.

**Fëmijët:** Ju duhet të përfshini të GJITHË fëmijët tuaj që janë të pamartuar dhe nën 21 vjeç në kohën e aplikimit tuaj fillestar E-DV, pavarësisht nëse janë fëmijët tuaj natyralë, fëmijët e bashkëshort-it/es tuaj (edhe pse tashmë mund të jeni i ndarë nga prindi i fëmijës), fëmijët e bashkëshort-it/es suaj, apo fëmijët që ju keni adoptuar zyrtarisht në përputhje me ligjet e vendit tuaj. Përfshini të gjithë fëmijët nën 21 vjeç në kohën e aplikimit tuaj elektronik, edhe nëse ata nuk banojnë me ju apo nuk mendoni që ata do të emigrojnë në kuadrin e programit DV. Nuk ju kërkohet të përfshini fëmijët të cilët tashmë janë shtetas Amerikanë apo Rezidentë të Përhershëm Ligjorë, sidoqoftë ju nuk do të cënoheni nëse i përfshini ata.

Prindërit apo motrat/vëllezërit e të regjistruarit janë të papërshtatshëm për të përfshirë statusin e personave në ngarkim, dhe nuk duhet të përfshihen në formularin tuaj.

Nëse përfshini pjesëtarët e familjes në aplikimin tuaj, nuk është e domosdoshme për ta që të aplikojnë për vizë apo të udhëtojnë me ju. Megjithatë, në qoftë se ju përfshini më vonë në aplikimin tuaj për vizë një person i cili është në varësinë tuaj të ligjshme, dhe që nuk e keni përfshirë në aplikimin elektronik fillestar, rasti juaj do të skualifikohet. Kjo vlen vetëm për ata që ishin anëtarë të familjes në kohën kur është dorëzuar aplikimi origjinal, jo ata të përfshirë në një datë të mëvonshme nga aplikimi fillestar. Bashkëshorti/ja juaj, nëse i përmbush kushtet për aplikim, ende mund të dorëzojë një formular më vete edhe pse ai/ajo është radhitur në aplikimin tuaj, për sa kohë që të dy aplikimet të përfshijnë detaje mbi të gjithë vartësit në familjen tuaj. (shikoni pyetje dhe përgjigje nr.12 më sipër).

**14. Duhet të aplikoj vetë, apo dikush tjetër mund të aplikojë për mua?**

Ju inkurajojmë të përgatisni dhe dorëzoni aplikimin tuaj (aplikimin elektronik fillestar), por mund të keni edhe dikë tjetër që t'ju ndihmojë të aplikoni. Pavarësisht se nga kush është bërë aplikimi fillestar për lotarinë, pra nga vetë individi, apo nga një avokat, mik, i afërm, etj., vetëm një regjistrim mund të paraqitet në emrin tuaj. Ju si aplikant keni përgjegjësinë të siguroheni që informacioni i dërguar në formularin e regjistrimit është i saktë dhe i plotë; formularët që nuk janë të saktë dhe të plotë do të shkualifikohen. Aplikantët duhet të ruajnë numrin personal të konfirmimit që të mundën në mënyrë të pavarur, të kontrollojnë statusin e aplikimit të tyre nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistrimit (Entry Status Check) në [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov).

**15. Unë tashmë jam regjistruar në një kategori tjetër për vizë emigrimi. A mundem ende të aplikoj për programin e DV-së?**

Po.

**16. Kur do të jetë në dispozicion E-DV-ja elektronikisht?**

Ju mund të hyni në internet gjatë periudhës së regjistrimit që fillon në 12:00 (mesditë) Ora Ditore Lindore (EDT) (GMT-4) E martë, 1 Tetor 2013; dhe do të përfundojnë në 12:00 (mesditë), Ora Ditore Lindore (EDT) (GMT-4) E Shtunë, 2 Nëntor 2013.

**17. A do të mundem të shkarkoj dhe ruaj formularin elektronik E-DV si document dhe ta plotësoj më pas?**

Jo, ju nuk do të jeni në gjendje që të ruani formularin e plotësuar në një program tjetër dhe ta dorëzoni atë më vonë. Formulari i regjistrimit për lotari E-DV është formular vetëm për internet. Ju duhet të plotësoni informacionin dhe ta dorëzoni ndërkohë që jeni online.

**18. A mundem të ruaj formularin në internet dhe ta përfundoj atë më vonë?**

Jo. Formulari i regjistrimit të E-DV-së (lotarisë elektronike) është projektuar që të plotësohet dhe dorëzohet njëherësh. Ju do të keni (60) minuta kohë që fillon me shkarkimin dhe plotësimin e formularit, deri në përfundimin dhe regjistrimin në adresën e internetit të E-DV-së. Nëse më shumë se gjashtëdhjetë minuta kalojnë dhe ju nuk e keni përfunduar dhe regjistruar formularin tuaj në mënyrë elektronike, informacioni i dhënë deri në atë moment do të fshihet. Sistemi fshin të gjitha regjistrimet e pjesshme që më vonë të mos përcaktohet aksidentalisht si dublikatë apo formular.

Lexoni deri në fund udhëzimet përpara se të filloni plotësimin e formularit, që të dini saktësisht çfarë informacioni do t'ju nevojitet.

**19. Unë nuk kam skaner. A mundem të dërgoj fotografitë tek dikush në Shtetet e Bashkuara për t'i skanuar, ruajtur dhe postuar përsëri tek unë që t'i përdor në regjistrimin tim?**

Po, kjo mund të bëhet për aq kohë sa fotografia plotëson kërkesat sipas udhëzimeve dhe dërgohet elektronikisht në të njëjtën kohë me regjistrimin elektronik të lotarisë E-DV. Ju duhet të keni fotografinë e skanuar në formular kur të regjistroheni elektronikisht për programin; fotografia nuk mund të paraqitet veçmas formularit elektronik. Regjistrimi i plotë (fotografi dhe formular së bashku), mund të plotësohet në mënyrë elektronike nga Shtetet e Bashkuara apo nga jashtë.

**20. Sipas procedurave, sistemi nuk do të pranojë formularin fillestar E-DV nëse fotografitë e mia nuk i plotësojnë të dhënat teknike. A mundem të ridërgoj formularin tim?**

Po. Nëse fotografia/ (fotografitë) nuk i plotësojnë të dhënat teknike, regjistrimi juaj nuk do të pranohet nga interneti i E-DV-së, kështu që ju nuk do të merrni një njoftim konfirmues. Megjithatë, duke u nisur nga natyra e paparashikueshme e internetit, ju mund të mos e merrni menjëherë njoftimin për refuzim. Nëse ju mund të korrigjoni fotografinë /(fotografitë) dhe të ridërgoni Pjesën e Parë apo të Dytë të formularit brenda 60 (gjashtëdhjetë) minutave, ju mund të jeni në gjendje që të paraqisni regjistrimin tuaj me sukses. Përndryshe, do t'ju nevojitet të rifilloni procesin e regjistrimit. Ju duhet të mundoheni të paraqisni një formular aq herë sa të jetë e nevojshme deri në pranimin e plotë të formularit dhe deri në njoftimin për marrjen e konfirmimit. Njëherë që merrni njoftimin për konfirmim, regjistrimi juaj ka përfunduar dhe ju NUK duhet të paraqisni një regjistrim shtesë.

**21. Sa shpejt pas regjistrimit të formularit do të marr njoftimin për konfirmimin elektronik?**

Ju duhet të merrni njoftimin konfirmues menjëherë, sëbashku me numrin e konfirmimit i cili duhet ruajtur dhe mbajtur. Megjithatë, duke u nisur nga natyra e paparashikueshme e internetit, mund të njoftoheni me vonesë. Ju mund të shtypni butonin "Submit" sa herë të jetë e nevojshme deri në pranimin e plotë të formularit dhe deri në njoftimin për marrjen e konfirmimit. Megjithatë, sapo të merrni njoftimin konfirmues, mos e ridërgoni informacionin tuaj.

## **PËRZGJEDHJA**

**22. Si mund ta di nëse unë jam përzgjedhur?**

Ju duhet të përdorni numrin tuaj të konfirmimit nëpërmjet Kontrollit të Statusit të të Regjistruarve (Entry Status Check), në faqen e internetit të E-DV-së [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov) nga 1 Maji 2014 të paktën deri në Shtator 2015. Kontrollit të Statusit të Regjistrimit është mënyra e vetme që do t'ju njoftojë juve për përzgjedhjen, do t'ju ofrojë udhëzime të mëtejshme sesi të vazhdoni aplikimin, t'ju njoftojë për datën dhe orën e takimit të intervistës për vizë.

Faqja e vetme e internetit e autorizuar nga Departamenti i Shtetit për regjistrimin e Vizës së Shumëllojshmërisë dhe për të Kontrolluar Statusin e të Regjistruarve (Entrant Status Check) është [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov).

Departamenti i Shtetit NUK do t'ju kontaktojë që t'ju njoftojë nëse jeni përzgjedhur (shikoni pyetje dhe përgjigje nr.23 më sipër).

### **23. Si do ta dalloj nëse nuk jam përzgjedhur? A do të njoftohem?**

Ju mund të kontrolloni statusin e regjistrimit tuaj për DV-2015 nëpërmjet Kontrollit të Statusit të të Regjistruarve (Entrant Status Check) në faqen e internetit E-DV [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov) duke filluar nga 1 Maji 2014, deri në 30 Qershor 2015. Ruajeni numrin tuaj të konfirmimit të paktën deri në 30 shtator 2015. (Informacioni rreth statusit për lotarinë e vitit të kaluar, DV-2014, është në dispozicion në internet nga 1 Maj 2013, deri në 30 Qershor 2014.) Nëse regjistrimi juaj nuk është përzgjedhur, ju nuk do të merrni udhëzime shtesë.

### **24. Po nëse humbas numrin tim të konfirmimit?**

Ju duhet të keni numrin tuaj të konfirmimit që të hyni tek Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve. Një buton është tani në dispozicion në Kontrollin të Statusit të të Regjistruarve (ESC) në faqen e internetit E-DV që do t'ju lejojë të rifitoni numrin tuaj të konfirmimit përmes adresës së regjistruar të postës elektronike duke plotësuar informacione të caktuara personale për të konfirmuar identitetin tuaj.

Ambasadat dhe Konsullatat e SHBA-së dhe Qendra Konsullore në Kentucky nuk janë në gjendje që të kontrollojnë statusin tuaj të regjistrimit për ju apo të sigurojnë numrin tuaj të konfirmimit tek ju direkt (përveç butonit gjetës nëpërmjet ESC). Departamenti i Shtetit nuk është në gjendje të sigurojë një listë të atyre që përzgjidhen për të vazhduar procesin e vizave.

### **25. A do të marr unë informacion nga Departamenti i Shtetit me adresë elektronike (e-mail) apo me postë?**

Departamenti i Shtetit nuk do t'ju dërgojë një letër njoftimi. Qeveria amerikane asnjëherë nuk ka dërguar e-mail për të njoftuar ata individë që kanë janë të përzgjedhur, dhe nuk ka planifikon që të përdorë e-mail për qëllimi të tilla si programin e DV-2015. Nëse ju jeni përzgjedhur, ju vetëm do të merrni e-mail komunikimi në lidhje me caktimin tuaj për vizë, pasi ti jeni përgjigjur udhëzimeve të njoftimit mbi Kontrollin e Statusit të të Regjistruarve. Këto email nuk do të përmbajë informacion mbi datën dhe kohën e takimit ekzistues, thjesht do t'ju tregojnë se detajet takimit janë në dispozicion dhe ju duhet pastaj të kontrolloni Statusin e të Regjistruarve.

Vetëm faqet e internetit që përfundojnë me prapashtesën ".gov" janë faqet zyrtare të internetit të qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Shumë faqet e internetit të tjera (p.sh., me prapashtesat ". Com", ". Org," ose ". Net") mund të sigurojnë informacione në lidhje me emigracionin dhe shërbimet e vizave. Departamenti i Shtetit nuk i vërteton, nuk i rekomandon, as sponsorizon informacionin ose materialin në këto faqet e tjera të internetit.

Ju mund të merrni email nga faqet interneti që përpiqen t'ju mashtrojnë t'u dërgoni para apo informacionin tuaj personal. Mund t'ju kërkohet që të paguani për formularët dhe informacionet në lidhje me procedurat e emigracionit, të cilat janë të gjitha në dispozicion falas në faqen e internetit të Departamentit të Shtetit ose përmes Ambasadës Amerikane apo faqet e internetit të Konsullatës. Përveç kësaj, organizatat apo faqet e internetit mund të përpiqen të vjedhin paratë tuaja duke ju ngarkuar pagesa për shërbime të lidhura me llotarinë. Nëse ju i

dërgoni të holla ndokujt prej këtyre mashtrimeve, mund të ketë të ngjarë që ju kurrë nuk ta shihni ata përsëri. Gjithashtu, mos dërgoni informacion personal në këto faqe e interneti, pasi mund të përdoret për mashtrim të identitetit / vjedhje.

## 26. Sa individë do të përzgjidhen?

Për DV-2015 janë në dispozicion 50.000 Viza DV. Për shkak se ka të ngjarë që një pjesë e 50.000 aplikantëve të përzgjedhur nuk do të kualifikohen ose nuk do të ndjekin (vazhdojnë) rastet e tyre për lëshimin e vizave, më shumë se 50.000 regjistrime do të përzgjidhen për të siguruar që të gjitha vizat e vëna në dispozicion për llotarinë të jenë lëshuar. Gjithsesi, kjo gjithashtu do të thotë se mund të mos ketë një numër të mjaftueshëm vizash për të gjithë ata që janë përzgjedhur fillimisht. Ju mund të kontrolloni nëpërmjet Statusit të Regjistrimit (Entrant Status Check) dhe në faqen e internetit të E-DV-së nëse jeni përzgjedhur për procesim të mëtejshëm, si dhe për radhitjen e tyre në listë. Intervistat për programin e DV-2015-s do të fillojnë në Tetor 2014 për ata të përzgjedhur të cilët kanë dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar para intervistës dhe informacion tjetër siç mund t'u jetë kërkuar në udhëzimet e njoftimit. Të përzgjedhurit, të cilët plotësojnë informacionin e kërkuar në udhëzime, do të informohen për datën e intervistës së tyre për vizë nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistrimit në faqen e internetit të E-DV-së 4-6 javë para intervistës së planifikuar me zyrtarët konsullorë të SHBA-së në vendet e huaja.

Çdo muaj, do të lëshohen viza për aplikantët që kualifikohen gjatë atij muaji, aq sa lejon numri në dispozicion për lëshimin e vizave. Pasi të gjitha 50.000 vizat për llotari të jenë lëshuar, programi do të përfundojë. Në parim, numrat e vizave mund të përfundojnë përpara Shtatorit 2015. Aplikantët e përzgjedhur të cilët dëshirojnë të marrin

vizë duhet të jenë të përgatitur që të dokumentojnë me përpikmëri rastet e tyre. Përzgjedhja e rastësishme si i përzgjedhur nuk garanton që ju do të merrni një vizë. Përzgjedhje do të thotë vetëm që ju jeni i ligjshëm të aplikoni për një Vizë Shumëllojshmërie (llotarie) dhe nëse kualifikoheni, t'ju lëshohet një vizë e Shumëllojshmërisë. Vetëm 50.000 aplikantët e parë të **përzgjedhur që do jenë të kualifikuar do të pajisen me vizë dhe ju duhet të kualifikoheni për vizën.**

## 27. Si do të përzgjidhen regjistruarit e suksesshëm?

Njoftimet zyrtare të përzgjedhjes do të bëhet nëpërmjet Kontrollit të Statusit Hyrës, në dispozicion duke filluar nga 1 Maj 2014, deri së paku më 30 Qershor 2015, në faqen e internetit E-DV [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov) internetit. Departamenti i Shtetit nuk do të dërgojë njoftime për të përzgjedhurit apo letra me postë ose email. Çdo njoftim me email ose letër që ju deklaron se jeni përzgjedhur për të marrë llotarinë nuk vjen nga Departamenti i Shtetit dhe nuk është i ligjshëm. Çdo komunikim me email që ju merrni nga Departamenti i Shtetit do t'ju drejtojë juve për të rishikuar Kontrollin e Statusit Hyrës për informacion të ri në lidhje me aplikimin tuaj. Departamenti i Shtetit nuk do t'ju kërkojë kurrë të dërgoni para me postë apo me shërbime të tilla si Western Union.

## **27. Si do të përzgjidhen të regjistruarit?**

Të gjitha regjistrimeve të marra nga secili rajon do t'i caktohet një numër individual dhe në përfundim të periudhës së regjistrimit, një kompjuter do të përzgjedhë rastësisht aplikime të marra nga secili rajon gjeografik. Brenda secilit rajon, aplikimi i parë i zgjedhur rastësisht do të jetë rasti i parë i regjistruar, aplikimi i dytë i përzgjedhur do të jetë rasti i dytë i regjistruar, etj. Të gjitha regjistrimet e marra gjatë periudhës së aplikimit do të ketë një shans të barabartë për të qenë të përzgjedhur në çdo rajon. Kur një regjistrim është përzgjedhur, aplikanti do të njoftohet për zgjedhjen e tij/saj nëpërmjet Kontrollit të Statusit të të Regjistruarve (Entrant Status Check) që do të vihet në dispozicion nga 1 Maji 2014 në faqen e internetit të E-DV-së [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov). Në qoftë se ju jeni përzgjedhur dhe ndiqni udhëzimet e dhëna online nëpërmjet Kontrollit të Statusit të të Regjistruarve, Qendra Konsullore në Kentucky (KCC) e Departamentit të Shtetit do të shqyrtojë rastin derisa kandidatët e përzgjedhur për intervistë të marrin udhëzimet për t'u paraqitur në intervistë për vizë në një Ambasadë ose Konsullatë të SHBA, ose derisa ata që ndodhen në SHBA, të aplikojnë në një zyrë lokale të USCIS për të rregulluar statusin.

## **28. Unë ndodhem tashmë në Shtetet e Bashkuara. Nëse përzgjidhem, a mund të rregulloj statusin pranë USCIS?**

Po, ju mund të aplikoni pranë USCIS për rregullim të statusit si banor i përhershëm me kusht që ju të jeni i pranueshëm për të rregulluar statusin sipas kushteve ligjore të nenit 245 të INA-s. Ju duhet të siguroheni që USCIS do të mbarojë veprimet në rastin tuaj, duke përfshirë shqyrtimin para 30 Shtatorit 2015 edhe të ndonjë bashkëshorti/bashkëshorteje apo fëmije nën moshën 21 vjeç që ndodhen jashtë Amerikës, pasi në atë datë mbaron përzgjedhshmëria juaj për programin e DV-2015. Në asnjë rrethanë nuk do të mundësohen numra vizash të programit të DV-2015 apo rregullim i statusit pas mesnatës (EDT) më 30 Shtator 2015.

## **29. Nëse jam përzgjedhur, për sa kohë kam të drejtë të aplikoj për një vizë të kategorisë së DV-së?**

Personat e përzgjedhur për programin e lotarisë DV-2015 kanë të drejtë të aplikojnë për lëshimin e vizave vetëm gjatë vitit fiskal 2015 të Departamentit të Shtetit, i cili shtrihet nga 1 Tetori 2014 deri më 30 Shtator 2015.

**Pa përjashtim, të gjithë aplikantët e përzgjedhur dhe të pranueshëm duhet të pajisen me vizë ose të rregullojnë statusin e tyre deri në përfundim të vitit fiskal.** Nuk përfitojnë asnjë shtyrje të lotarisë për vitin e ardhshëm personat që janë përzgjedhur, por që nuk janë pajisur me vizë deri më 30 Shtator 2015 (fundit i vitit fiskal). Gjithashtu, bashkëshortët dhe fëmijët që përfitojnë nga statusi i një të regjistruarit të DV-2015 mund të pajisen me viza në kategorinë e DV-së vetëm nga 1 Tetori 2014 deri më 30 Shtator 2015. Aplikantët që aplikojnë jashtë kufijve të Amerikës do të marrin një njoftim nga Departamenti nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistrimit në faqen e internetit të E-DV-së katër deri në gjashtë javë përpara datës së takimit të planifikuar për intervistë.

## **30. Nëse një i përzgjedhur për programin e DV-2015 vdes, çfarë ndodh me rastin?**

Nëse një i përzgjedhur vdes kurdo para se të udhëtojë në Shtetet e Bashkuara, rasti i DV-së do të revokohet automatikisht. Çdo bashkëshort/e dhe fëmijët e regjistruar nuk kanë më të drejtë për vizë lotarie.

## **TARIFAT**

## **31. Sa kushton regjistrimi në programin e E-DV-së?**



**Aktualisht nuk ka asnjë tarifë për t'u regjistruar elektronikisht për lotarinë.** Sidoqoftë, nëse ju jeni përzgjedhur, duhet të paguani të gjitha tarifat për vizë të kërkuara në kohën e aplikimit për vizë si dhe intervistë drejtpërdrejt tek arkëtari konsullor në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara apo Konsullatën. Nëse ju jeni një i përzgjedhur që ndodheni tashmë në SHBA, dhe aplikoni pranë USCIS për të rregulluar statusin, ju do t'i paguani të gjitha tarifat e kërkuara direkt pranë USCIS. Nëse jeni përzgjedhur, ju do t'i merrni detajet mbi tarifat e kërkuara të aplikimit për vizë emigrimi të DV-së bashkë me udhëzimet e dhëna nëpërmjet faqes së internetit të E-DV-së në [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov)

**32. Si dhe ku do të paguaj tarifat e vizës së emigrimit dhe DV-së nëse jam i përzgjedhur?**

Nëse ju jeni një aplikues i përzgjedhur rastësisht, do të merrni udhëzimet mbi përpunimin e aplikimit të vizës së DV-së nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarve tek [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov). Ju do të paguani të gjitha tarifat e DV-së dhe vizës së emigrimit personalisht vetëm në Ambasadën ose Konsullatën e SHBA -së në kohën e aplikimit për vizë. Arkëtari konsullor do ju japë menjëherë një faturë të qeverisë së SHBA-së për pagesën. Mos i dërgoni para askujt për tarifat e DV-së nëpërmjet postës, Western Union, ose kujtdo shërbimi tjetër dërgesash nëse ju jeni duke aplikuar për një vizë emigrimi në një Ambasadë ose Konsullatë të Shteteve të Bashkuara.

Nëse ju jeni përzgjedhur dhe ndodheni tashmë në Shtetet e Bashkuara, dhe planifikoni të depozitoni një kërkesë për rregullimin e statusit pranë USCIS, fleta e udhëzimeve e aksesueshme nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarve tek [www.dvlottery.state.gov](http://www.dvlottery.state.gov) përmban udhëzime të veçanta se si të dërgoni tarifat e DV-së pranë një banke amerikane.

**33. Nëse aplikoj për DV, por nuk kualifikohem për të marrë një vizë të tillë, a mund të më rimburohet tarifa që kam paguar për vizë?**

Jo. Tarifat e vizave nuk mund të rimburohen. Ju duhet të përmbushni kualifikimet për vizë ashtu siç është specifikuar në këto udhëzime. Në rast se zyrtari konsullor vendos se ju nuk i përmbushni të gjitha kërkesat për vizë ose se ju nuk jeni i pranueshëm për Vizën e Shumëllojshmërisë, sipas ligjit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, oficeri nuk mund t'ju lëshojë vizë dhe do t'ju mbahen tarifat e paguara.

***PAPRANUESHMËRITË***

**34. Si një aplikant DV-je, a mund të marr falje për çfarëdo rast të papranueshmërisë për vizë? A konsiderohet sipas një shqyrtimi special aplikimi im për falje?**

Jo; Aplikantët e DV-së janë subjekt i të gjitha rasteve të papranueshmërisë për vizat emigruese të specifikuar në Aktin e Emigracionit dhe Shtetësisë (INA). Nuk parashikohen dispozita të veçanta për falje të asnjë rasti të papranueshmërisë për vizë duke lënë mënjane ato të parashikuara zakonisht në INA, as nuk ka shqyrtim të veçantë për kërkesat për falje. Disa dispozita të përgjithshme për falje për njerëzit që kanë të afërm të ngushtë që janë nënshetas të SHBA-së ose të huajve rezidentë të përhershëm të ligjshëm mund të jenë të disponueshme edhe për aplikantët e DV-së në disa raste, por koha e kufizuar për programin e DV-së do ta bëjë të vështirë që aplikantët të përfitojnë nga dispozita të tilla.

***PARALAJMËRIMET DHE MASHTRIMET MBI DV-NË***

**35. Si mund ta raportoj mashtrimin në internet ose një email të padëshiruar?**



Ju lutemi vizitoni faqen e internetit [www.econsumer.gov](http://www.econsumer.gov), të organizuar nga Komisioni Federal i Tregtisë, në bashkëpunim me agjencitë për mbrojtjen e konsumatorit nga 17 shtete. Ju gjithashtu mund të raportoni mashtrimin në Zyrën Federale të Hetimeve (FBI) [Qendra e Ankesës për Krimin në Internet \(Internet Crime Complaint Center\)](#). Për të depozituar një ankesë rreth një emaili të padëshiruar, vizitoni faqen e Departamentit të Drejtësisë [\(Department of Justice Contact Us page\)](#).

## **STATISTIKAT E DV-SË**

### **36. Sa viza do lëshohen për DV-2015?**

Sipas ligjit, një maksimum prej 55,000 vizash janë të disponueshme çdo vit për personat e pranueshëm. Megjithatë, në nëntor të vitit 1997, Kongresi miratoi Aktin e Asistencës për Amerikën Qendrore dhe Rregullimin Nikaraguan (NACARA), i cili përcakton se duke filluar që nga DV-1999 dhe për atë kohë sa është e nevojshme, deri në 5,000 numra vizash nga 55,000 DV të caktuara çdo vit do të vihen në dispozicion për përdorim në kuadrin e programit NACARA. Reduktimi aktual i kufizimit filloi me DV-2000 dhe do të mbetet në fuqi edhe për DV-2015, kështu që për programin e DV-së mbeten 50,000 viza, siç është e përshkruar në udhëzime.

## **TË NDRYSHME**

### **37. Nëse unë marr një vizë nëpërmjet programit të DV-së, a do të më paguajë qeveria e SHBA-së pagesën e udhëtimit për në SHBA, a do të më ndihmojë për të gjetur strehim dhe punë dhe/ose a do më japë kujdes mjekësor apo ndonjë ndihmë tjetër financiare derisa unë të rregullohem plotësisht?**

Jo. Qeveria e SHBA-së nuk do të japë asnjë nga këto shërbime nëse ju merrni një vizë nëpërmjet programit të DV-së. Nëse ju jeni përzgjedhur për të aplikuar për një vizë DV-je, do t'ju kërkohet të dëshmoni se nuk do të bëheni barrë publike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpara se të pajiseni me vizë. Këto të dhëna mund të jetë në formën e një kombinimi të pasurive tuaja personale, një Garanci Mbështetjeje (Formulari I-134), i paraqitur nga një i afërm apo mik që banon në Shtetet e Bashkuara, një ofertë për punësim nga një punëdhënës në Shtetet e Bashkuara, ose evidencë tjetër.

## **LISTA E VENDEVE/ZONAVE SIPAS RAJONIT, VENDASIT (TË LINDURIT) E TË CILËVE JANË TË PRANUESHËM (kanë të drejtë të aplikojnë) PËR LOTARINË DV-2015**

Lista e mëposhtme paraqet vendet, vendasit (të lindurit) e të cilëve janë të ligjshëm për Lotarinë DV-2015, të grupuar sipas rajonit gjeografik. Zonat e jashtme në varësi janë përfshirë brenda rajonit të shtetit që e qeveris. Vendet, banorët (të lindurit) e të cilëve janë të pranueshëm për programin e lotarisë DV-2015 janë identifikuar nga USCIS (Shërbimi i Emigracionit dhe Nënshetësisë të Shteteve të Bashkuara), sipas formulës së Seksionit 203(c) të INA-s. Vendet, vendasit (të lindurit) e të cilëve nuk janë të pranueshëm për programin e lotarisë DV (sepse janë burimi kryesor i emigracionit me sponsorizim familjar dhe i emigracionit me bazë punësimi ose vende me "përqindje të lartë të pranimit të emigrantëve") janë të renditura pas listës respektive rajonale.

### **AFRIKA**

Algjeria  
Angola  
Benini

Botsvana  
Burkina Faso  
Burundi

Kameruni  
Kepi Jeshil  
Republika e Afrikës Qëndrore  
Çadi  
Komoros  
Kongo  
Republika Demokratike e Kongos  
Bregu i Fildishtë  
Xhibuti  
Egjipti\*  
Guinea Ekuatoriale  
Eritrea  
Etiopia  
Gaboni  
Gambia  
Gana  
Guinea  
Guinea-Bissau  
Kenia  
Lesoto  
Liberia  
Libia  
Madagaskar  
Malavi

Mali  
Mauritania  
Mauricius  
Maroku  
Mozambiku  
Namibia  
Nigeri  
Ruanda  
Sao Tome dhe Principe  
Senegali  
Sejshell  
Sierra Leone  
Somalia  
Afrika e Jugut  
Sudani Jugor  
Sudani  
Svazilandi  
Tanzania  
Togo  
Tunizia  
Uganda  
Zambia  
Zimbabve

\*Personat e lindur në zonat e administruara para qershorit 1967 nga Izraeli, Jordania, Siria dhe Egjipti, janë respektivisht në ngarkim të Izraelit, Jordanisë, Sirisë dhe Egjiptit. Personat e lindur në Rripin e Gazës janë në ngarkim të Egjiptit; personat e lindur në Bregun Perëndimor janë në ngarkim të Jordanisë; personat e lindur në Lartësitë Golan janë në ngarkim të Sirisë. Në Afrikë, vendasit/personat e lindur në Nigeri nuk janë të pranueshëm për programin e lotarisë së këtij viti.

## **AZIA**

Afganistani  
Bahreini  
Butani  
Brunei  
Burma  
Kamboxhia  
Timori Lindor  
\*\*Rajoni Admistrativ i Veçantë i Hong  
Kongut  
Indonezia  
Iran  
Irak  
Izraeli\*  
Japonia  
Jordania\*  
Kuvaiti

Laos  
Libani  
Malajzia  
Ishujt Maldivë  
Mongolia  
Nepal  
Koreja e Veriut  
Omani  
Katar  
Arabia Saudite  
Singapori  
Sri Lanka  
Siria  
Tajvan  
Tajlanda  
Emiratet e Bashkuara Arabe

Jemeni

\*Të lindurit e vendeve të Azisë të renditura më poshtë, **nuk** janë të ligjshëm për programin e Lotarisë së këtij viti: Bangladesh, Kina, India, Pakistani, Koreja e Jugut, Filipinet dhe Vietnami. Rajoni me Administrim të Veçantë i Hong Kongut, Rajoni me administrim të veçantë i Makaut dhe Tajvani **kualifikohen** dhe janë renditur më sipër.

\*\*Personat të lindur para Qershorit 1967 në zonat e administruara nga Izraeli, Jordania dhe Siria janë në ngarkim, respektivisht, të Izraelit, Jordanisë dhe Sirisë. Personat e lindur në Rripin e Gazës janë në ngarkim të Egjiptit; personat e lindur në West Bank janë në ngarkim të Jordanisë; persoante lindur në Golan janë në ngarkim të Sirisë.

## **EUROPA**

Shqipëria

Andora

Armenia

Austria

Azerbaixhani

Bjellorusi

Belgjika

Bosnja dhe Herzegovina

Bullgaria

Kroatia

Qipro

Republika Çeke

Danimarka (përfshirë vendet në varësi të saj)

Estonia

Finland

France (përfshirë vendet në varësi të saj)

Gjeorgjia

Germany

Greece

Hungaria

Islanda

Irlanda

Itali

Kazakistan

Kosova

Kirgizistani

Letonia

Liechtenstein

Lituania

Luksemburg

Rajoni me Administrim të Veçantë i Makaut

Maqedonia

Malta

Moldavia

Monako

Mali I Zi

Holanda (përfshirë vendet në varësi të saj)

Irlanda e Veriut

Norvegjia

Polonia

Portugalia (përfshirë vendet në varësi të saj)

Rumania

Rusia

San Marino

Serbia

Sllovakia

Sllovenia

Spanja

Suedia

Zvicra

Taxhikistan

Turqi

Turkmenistan

Ukraine

Uzbekistan

Qyteti i Vatikanit

\*\*Të lindurit e vendeve të Europës të renditura si më poshtë, **nuk** kanë të drejtë të aplikojnë për programin e Lotarisë për 2014: Britania e Madhe. Britania e Madhe përfshin këto vendet të

varura prej saj: Anguila, Bermuda, Ishujt Britanikë Virxhin, Ishujt Kajman, Ishujt Falkland, Gjibraltari, Montserrat, Pitkairn, Shën Helena dhe Ishujt Kaikos dhe Turk. Irlanda e Veriut **kualifikohet** dhe është renditur mes vendeve kualifikuese. Makau S.A.R. **kualifikohet** dhe është renditur më lart.

### **AMERIKA E VERIUT**

Bahamas

Në Amerikën e Veriut, të lindurit në Kanada dhe Meksikë **nuk** kanë të drejtë të aplikojnë për programin e lotarisë së këtij viti.

### **OQEANIA**

Australia (përfshirë vendet në varësi të saj)

Fixhi

Kiribati

Ishujt Marshall

Mikronezia, Federata e Shteteve të

Nauru

Zelanda e Re (përfshirë vendet në varësi të saj)

Palau

Papua Guinea e Re

Ishujt Solomon

Tonga

Tuvalu

Vanuatu

Samoa

### **AMERIKA e JUGUT, AMERIKA QËNDRORE DHE KARAIBET**

Antigua dhe Barbuda

Argjentina

Barbados

Belize

Bolivia

Kili

Kosta Rika

Kuba

Dominika

Grenada

Guatemala

Guijana

Honduras

Nikaragua

Panama

Paraguaj

Shën Kits dhe Nevis

Santa Lucia

Saint Vincent dhe Grenadines

Suriname

Trinidad dhe Tobago

Uruguaj

Venezuela

Të lindurit në këto vende të rajonit **nuk** janë të ligjshëm (nuk kanë të drejtë të aplikojnë) për programin e lotarisë së këtij viti:

Brazili, Kolumbia, Republika Domenikane, Ekuadori, El Salvadori, Haiti, Xhamaika, Meksikë dhe Peru.